



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

Tiranë, më 21.03.2023

NJOFTIM

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURËS SË KONKURIMIT
PËR**

EMERIMIN NË POZICIONIN E PUNËS NJË VEND

FTUES

Bazuar në Ligjin Nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe funksionimi e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë , si dhe mbi bazën e “ Strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, me qëllim plotësimin e vendit vakant në zbatim të strukturës së Institucionit, në përmbushje të organikës Nr. 09 datë 18.01.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për vitin 2023 .

1. Kërkohet të punësohet 1(një) punonjës me emertese ftues, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së shkallës së Parë Tiranë, me adrese ,Rr. Haxhi.H. Dalliu Nr 97 Tiranë..

NJOFTON

1.Fillimin e Proçedurës së konkurimit të hapur të kandidateve për një pozicion me emertese ftues, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë .

2. Referuar neneve 74,75,76 të Ligjit nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë “, kandidatet e interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në punë, duhet të plotesojne dhe kriteret të veçanta.

1. Kandidatët për një pozicion të lire të punës “ftues“ duhet të paraqesin kërkesën së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm që kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur
- d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;
- f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo administrata shtetërore që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- g) të ketë përfunduar arsimin e mesëm apo të lartë

Kushtet e veçanta :

- a) Kërkesë për punësim,
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së mesme ose të lartë , liste notash e fotokopjuar dhe e noterizuar
- e) Dëshmi kualifikimi (nese ka)
- f) Vërtetim përmbartimi gjyqësor
- g) Vërtetim për gjendjen gjyqësore (Dëshmi penaliteti).
- h) Vërtetim nga Gjykata .
- i) Vërtetim nga Prokuroria
- j) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- k) Vërtetim i njësisë administrative
- l) Vërtetim mjekësor për gjendjen shëndetësore i afte për punë
- m) Vërtetim se ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore në marredhënie punedhe /ose ndonjë masë tjetër disiplinore

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet nga dt. 21.03.2023 ora 8.00 deri në datë 06.04.2022 ora 16.00, në K/sekretarinë e Prokurorisë Pranë gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë , Rr “ Haxhi.H. Dalliu “ Nr 97 Tiranë .

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLË SË PARË
TIRANË**